




LEGALIZ
NDËRTIMIN
MOS E HUMB MUNDËSINË!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning



Kontakti: Komuna e Vitisë
Adresa: rr. Hasan Kabashi
61000, Viti, Kosovë

Sipas Udhëzimit Administrativ Nr.06/2019,
Komuna është Organi Kompetent për lëshimin e Çertifikatës së Legalizimit për Ndërtime te Kategorisë I dhe Kategorisë II

Njoftim Publik

-Qytetar të nderuar të komunës së Vitisë,ju informojmë se procedurat për procesin e legalizimit të objekteve pa leje do të fillojnë menjëher pas fazës përfundimtare të pandesmisë Covid 19.

Për proceduarat e legalizimit të objekteve do të informoheni edhe në fletushkat e paraqitura në këtë informatë, por edhe nëpërmjet mjeteve të informimit.

NJOFTIM PUBLIK

UDHËZUES PËR QYTETARËT E VITISË RRETH PROCESIT TË LEGALIZIMIT

1. PSE DUHET TË LEGALIZOHET NDËRTIMI?

Ndërtimi mund të përdoret si kolateral legjitim dhe mund të përdoret më të drejta të plota. Në momentin që legalizoni ndërtimin, komuna bën planifikimin duke ju mundësuar kushtet e nevojshme që ju takojnë.

2. ZYRA ONE-STOP SHOP

Të gjitha informatat, procedurat dhe formularët e aplikimit për legalizimin e ndërtimit tuaj, tani mund ti merrni në zyrën e veçantë të sektorit për legalizimi në ndërtesën e re të Komunës së Vitisë.

3. TAKSAT PËR LEGALIZIM

□ **Kategoria I dhe Shtëpitë e Kat.II**

• Shuma më e madhe se 800 € mund të paguhet me dy këste me afat 30 ditë.

□ **Kategoria II dhe Ndërrhyrjet pa leje në ndërtimet me leje**

• Kategoria II shuma më e madhe se 10000€ mund të paguhet me dy këste me afat 60 ditë.

□ **Lirimet nga taksat**

• Ndërtimet me interes publik apo financim të Qeverisë
• Të rindërtuara nga lufta, konfliktet, trazirat shoqërore ose forcës madhore
• Përfituesit e skemës sociale, familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës, veteranët e luftës, ish-të burgosurit politikë, personat me aftësi të kufizuar, si dhe të gjitha kategoritë tjera të liruar sipas legjislacionit në fuqi, (lirohen pronarët e ndërtimeve pa leje të Kategorisë I dhe Kategorisë II që janë shtëpi)
• Ndërtimet e evidencuara në ortofotone vitit 2004
Aplikuesi duhet të plotësoj formularin për lirim nga taksat për legalizim. (Shtojca 3)

□ **Taksa për punët ndërtimore shtesë**

• Bazohet në taksën administrative dhe tarifën në fuqi për leje ndërtimore

1€/m²

2€/m²

0€/m²

4. CILAT NDËRTIME DUHET TI NËNSHTROHEN PROCESIT TË LEGALIZOHEN

□ Të gjitha ndërtimet pa leje të evidencuara në ortofoto para datës

□ **05 Shtator 2018** përfshirë këtu: shtëpitë, garazhat në shërbim të shtëpisë, ndërtesat bujqësore, shtëpitë me afarizem, depot, ndërtesat shumëbanesore dhe afariste, administrative, anekset dhe mbindertimet e ndërtesave, hotelet, konviktet, ndërtesat industriale, ndërtesat kulturore artistike, ndërtesat arsimore, shëndetsore, sportive (rekrative) etj.

□ Ndërtimet e papërfunduara

□ Tejkalime të lejës ndërtimore

KATEGORIA I DHE SHITËPITË E KATEGORISË II

Përfshihen këto ndërtime;

- Të gjitha shtëpitë e banimit
- Garazhat në shërbim të shtëpisë
- Shtëpi më afarizëm(banimit mbi 50%)
- Objektet bujqësore deri në 600m2
- Depo ku nuk deponohen materiale të rrezikshme

DOKUMENTACIONI QE DUHET TË DORËZOHET:

Ndërtimet pa leje të përfunduara :

- Formulari standard i aplikimit (Shtojca 1), (për ndërtimet pa leje të papërfunduara, Shtojca 2A)
 - Dëshmi mbi ndërtimin e kryer para dates 05.09.2018
- Deklaratae Pronarit të ndërtimit pa leje (Shtojca 1B)
- Dëshmitë mbi të drejtën pronësore (kopjene planit dhe certifikatën e pronësisë (jo me të vjetra se gjashtë muaj);
Leternjoftimin e aplikuesit
- Matjet/incizimine ndërtimit ekzistues pa leje (sipas udhëzuesit për legalizim, tri kopje fizike dhe një digjitale në format pdf dhe Dwg). Fotografike prezantojnë dukjen e ndërtimit pa leje;

Në rast se ndërtimi është I papërfunduar përveç

pikave të lartëcekura duhet të plotësohen dhe këto:

- Punët e planifikuara ndërtimore për përfundim të ndërtimit pa leje, nëse nuk bëhen punë ndërtimore shtesë që nuk ndërrojnë shputën apo lartësinë e ndërtimit ose ndryshojnë destinimin ekzistues.
- Për ndërtimet shtesë që ndërrojnë shputën ose lartësinë e ndërtimit ose e ndryshojnë destinimin ekzistues kërkohet projekti konceptual me kushtet e propozuara për përfundim të ndërtimit.

KATEGORIA II

Përfshihen këto ndërtime;

- Banimit më shumë njësi
- Konvikte apo ngjashëm
- Hotele apo ngjashëm
- Afarizem dhe administrate
- Industri, depo
- Art, kulturë, argëtim
- Arsim dhe shkencë
- Shëndetësi
- Sport, rekreacion
- Bujqësi

DOKUMENTACIONI QE DUHET TË DORËZOHET:

- Formulari standard i aplikimit (Shtojca 2) , (për ndërtimet pa leje të papërfunduara, Shtojca 2A)
- Dëshmi mbi ndërtimin e kryer para dates 05.09.2018
- Dëshmitë mbi të drejtën pronësore (kopjene planit dhe certifikatën e pronësisë (jo me të vjetra se gjashtë muaj);
- Leternjoftimin e aplikuesit
- Matjet/incizimine ndërtimit ekzistues pa leje (sipas udhëzuesit për legalizim, tri kopje fizike dhe një digjitale në format pdf dhe Dëg). –Fotografi qe prezantojnë dukjen e ndërtimit pa leje;
- Prezentimi grafik dhe përshkrimi i gjendjes ekzistuese të ndërtimit pa leje.
 - Raportin e stabilitetit të strukturës
 - Raporti i instalimeve të ujit dhekanalizimit.
 - Raporti i instalimeve mekanike.
 - Elaborati per për mbrojtje nga zjarri.
- Dokumentacionin e kompanisë projektuese që ka përgaditur këto raporte Në rast se ndërtimi është i papërfunduar përveç pikave të lartëcekura duhet të plotësohen dhe këto:
 - Prezentimi grafik , punët e planifikuara ndërtimore për përfundim të ndërtimit dhe përshkrimi i gjendjes ekzistuese për ndërtimin, nëse nuk bëhen punë ndërtimore shtesë që nuk ndërrojnë shputën apo lartësinë e ndërtimit ose ndryshojnë destinimin ekzistues.
 - Përndërtimet shtesë që ndërrojnë shputën ose lartësinë e ndërtimit ose ndryshojnë destinimin ekzistues kërkohet projekti konceptual me kushtet e propozuara për përfundim të ndërtimit

NJOFTIM PUBLIK

UDHËZUES PËR QYTETARËT E VITISË RRETH PROCESIT TË LEGALIZIMIT

LISTA E PRITJES

- Prona publike
- Prona shoqërore
- Tokat bujqësore nën komasacion dhe sistemtë ujitjes.
- Zonate Mbrojtura, Sipërfaqet e Mbrojtura, Zonate Veçanta të Mbrojtura, Zonate Veçanta
- Korridore te infrastrukturës

Qeveria do të miratojë programe për trajtim me propozim të Ministrisë

- PA pronësi të rregulluar ose pa të drejtë shfrytëzimi

Trajtohen pas rregullimit të të drejtës pronësore

LISTA E RRËNIMIT

- Nuk ka aplikim
- Refuzimi i legalizimit
- Revokimi i lejes së legalizimit për përfundim të ndërtimit

Kujdes!!! Nëse ju nuk aplikoni për legalizim të ndërtimit tuaj ju përfshihen në LISTEN E RRËNIMIT.

Komuna mund të bëjë rrënimin e ndërtimit pa asnjë kompenzim.